



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, datë 16 maj 2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Korrigjimin e pikës 1 të Vendimit nr. 31, datë 08.04.2024, të AMA-s, për heqjen e përcaktimit të zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Star” sh.p.k, autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online mbështetur në internet “Star Channel”. **(Vendim nr. 48, datë 16.05.2024)**
2. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Sky Elbasan” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Sky Elbasan”. **(Vendim nr. 49, datë 16.05.2024)**
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Digit-Alb” sh.a., licencuar për programin audioviziv numerik tokësor, autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv dhe për përsëritjen e programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet satelitor. **(Vendim nr. 50, datë 16.05.2024)**
4. Rinovimin e autorizimit dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, në: “*Bashkia Prrenjas*”, të subjektit person fizik Ergys Çaushti, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Prrenjas”. **(Vendim nr. 51, datë 16.05.2024)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 16 maj 2024